

VENDIM
Nr. 165, datë 18.3.2022

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 26, DATË 20.1.2021, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR
FINANCIMIN E RINDËRTIMIT/RIKONSTRUKSIONIT TË OBJEKTEVE
ARSIMORE NË BASHKITË KAMZË DHE KAVAJË, DHE ÇAKTIMIN E TYRE SI
NJËSI ZBATUESE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 13, shkronja “b”, nënndarjet “i” e “iii”, 16 dhe 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019; të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 26, datë 20.1.2021, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, pas pikës 2 shtohet pika 2/1, me këtë përmbajtje:

“2/1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, për vitin 2022, për financimin e rindërtimit/rikonstruksionit të objekteve arsimore, në Bashkinë Kamzë, në masën 93 387 241 (nëntëdhjetë e tre milionë e treqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e dyqind e dyzet e një) lekë pa TVSH, i cili përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2022, i cili i transferohet Bashkisë Kamzë, në formën e transfertës së pakushtëzuar dhe detajohet, si më poshtë vijon:

a) Rikonstruksionin e shkollës 9-vjeçare “Ahmet Zogu”, në masën 55 548 600 (pesëdhjetë e pesë milionë e pesëqind e dyzet e tetë mijë e gjashtëqind) lekë;

b) Rikonstruksionin e shkollës 9-vjeçare “Kamza e re”, në masën 8 303 236 (tetë milionë e treqind e tre mijë e dyqind e tridhjetë e gjashtë) lekë;

c) Rikonstruksionin e kopshtit “Kamza e re”, në masën 3 953 757 (tre milionë e nëntëqind e pesëdhjetë e tre mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e shtatë) lekë;

ç) Rikonstruksionin e kopshtit “Ahmet Zogu”, në masën 15 581 648 (pesëmbëdhjetë milionë e pesëqind e tetëdhjetë e një mijë e gjashtëqind e dyzet e tetë) lekë;

d) Rindërtimin e çerdhes Kamzë, në masën 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë.”.

2. Ngarkohen Zëvendëskryeministri dhe ministri i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Kamzë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama